

Cfarë ka ndryshuar?

Për herë të parë në Shqipëri, vlerësimi për aftësinë e kufizuar, bazohet në standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe vë në qendër të vëmendjes individin, duke e trajtuar me dinjitet dhe duke vlerësuar jo vetëm nevojat mjekësore por edhe ato sociale.

Në këtë vlerësim përfshihen individë dhe fëmijë me aftësi të kufizuar që duan të vlerësohen për herë të parë dhe ata persona që kërkojnë të rivlerësohen për aftësinë e kufizuar, duke vlerësuar diagnozën nëse ajo shoqërohet me kufizime që pengojnë veprimtaritë e jetës normale.

Ku ndodhen Komisionet e vlerësimit shumëdisiplinor?




Në qarkun e Lezhës funksionojnë 2 komisione:

1. Qendra Shëndetësore Milot;
2. Qendra Shëndetësore Lezhë;

REFORMA E VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR NË SISTEMIN E MBROJTJES SOCIALE

Si funksionon procesi i vlerësimit të individëve dhe fëmijëve me afësi të kufizuar?



1. Ju mund të merrni informacion të plotë për procedurën e vlerësimit pranë Administratorit Shoqëror të Njësisë Administrative ku keni vendbanimin si dhe nga mjeku i familjes.

2. Procesi fillon tek mjeku i familjes, i cili bën vlerësimin shëndetësor, plotëson formularin përkatës dhe ju referon tek mjeku specialist, përmes sistemit të referimit.

3. Mjeku specialist, pasi ka kryer vizitën dhe vlerësuar ekzaminimet tuaja shëndetësore, vendos diagnozën dhe plotëson formularin përkatës. Ju do të referoheni më pas në komisionin shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar që gjendet pranë vendbanimit tuaj.

4. Paraqitja në komisionin shumëdisiplinor, bëhet në orën dhe datën që ju është caktuar paraprakisht nga komisioni, i cili përbëhet nga profesionistë mjek dhe punonjës social. Në komision ju do të zhvilloni në formë bashkëbisedimi procedurën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Ju do të pyeteni rreth barrierave dhe vështirësive që hasni në kryerjen e veprimtarive të jetesës së përditëshme, si pasojë e funksioneve që ju ka prekur sëmundja.

5. Në përfundim të procedurës së vlerësimit, komisioni merr vendim për nivelin e aftësisë së kufizuar dhe përfitimet në pagesa, duke bërë gjithashtu edhe rekomandimet përkatëse.

Rekomandimet bëhen sipas nevojave tuaja për shërbime shëndetësore, psiko-sociale, të arsimit, punësimit, aftësimin profesional si dhe përfitimet në pagesa. Përfitimet në pagesa janë përshkallëzuar në 4 nivele për personin me aftësi të kufizuar dhe në 2 nivele për ndihmësin personal. Niveli i përfitimit përcaktohet nga komisioni në varësi të rëndesës së gjendjes, barrierave dhe nevojave për mbështetje të individit.

6. Ju do të njoftoheni mbi vendimin e komisionit zyrtarisht dhe do të asistoheni nga njësia administrative dhe Shërbimi Social Shtetëror, për marrjen e shërbimeve të rekomanduara nga komisioni.

7. Nëse nuk jeni dakord me vendimin e komisionit, ju keni të drejtë të ankoheni brenda 20 ditëve nga marrja e njoftimit në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, i cili do të shqyrtojë rastin tuaj përmes procedurës së vlerësimit.